



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:074750

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05656024

**P. nr. 39/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM / DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtor profesional Samir Morina, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.14/2024, të datës 23.04.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën PP/l.nr. 286/2022, të datës 23.03.2023, kundër të akuzuarve: A. Z. nga fshati T., Komuna e Malishevës së bashku me mbrojtësin e tij Bekim Kryeziu avokat në Malishevë, E.M. nga Malisheva Rr. "Gj. K. S." së bashku me mbrojtësen e tij Sahadete Gashi avokate në Prishtinë, dhe S.B. nga fshati D., Komuna e R., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale cenimi i të drejtave të punësimit dhe pa punësisë nga neni 219 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par. 1, nën par. 1.3 të KPP-së, si dhe nenit 2 par. 2, nenit 8, nenit 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), jashtë seancës më **02 maj 2024, nxjerri këtë:**

**A K T V E N D I M**

**I. MIRATOHET** marrëveshja me shenjë ND.nr. 14/2024, të datës 23.04.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Malishevë, ndërmjet të akuzuarve: A. Z. nga fshati T., Komuna e Malishevës, E. M. nga Malisheva Rr. "G. K. S.", S.B. nga fshati D., Komuna e R., si dhe të dëmtuarit R.M. nga fshati A., Komuna e Malishevës, në anën tjetër.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/l.nr. 286/2022, të datës 23.03.2023.

**III. PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarve: A. Z. nga fshati T., Komuna e Malishevës, E. M. nga Malisheva, si dhe S.B. nga fshati D., Komuna e Rahovecit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale cenimi i të drejtave të punësimit dhe pa punësisë nga neni 219 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se të pandehurit dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/l.nr. 286/2022, të datës 23.03.2023, kundër të akuzuarve: A. Z. nga fshati T., Komuna e Malishevës, E. M. nga Malisheva Rr. "Gj. K. S.", si dhe S. B. nga fshati D., Komuna e Rahovecit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale cenimi i të drejtave të punësimit dhe pa punësisë nga neni 219 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata më datë 11.03.2024, e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë e duke vepruar në bazë të nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Ndërmjetësim në Malishevë.

Më datë 23.04.2024 në Qendrën për Ndërmjetësim në Malishevë, është arritur marrëveshja me shenjën ND.nr. 14/2024, në mes të palëve në procedurë.

Andaj, gjykata duke vepruar në bazë të dispozitës së nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin më datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data **më 02 maj 2024**, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morë në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2, nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË**  
**DEPARTMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 39/2023, më 02 maj 2024**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Njazi MORINA**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.